

## **BATALIONET KUFITARE SHQIPTARE NË SEKTORIN E MAJTË TË DIBRËS DHE TË «FRONTIT SHQIPTAR» 1919-1921**

*Halim PURELLKU*

Tetovë

KUD 949.65 "1919-1921"  
Punim studimor

Marë për botim më 15. XII. 2000

*Përmbajtja e shkurtër:* Objekt studimi në këtë punim është rekrutimi dhe organizimi i mercenarëve shqiptarë në formacione ushtarake «nga ana e autoriteteve serbo-jugosllave, subvencionimi», motivet e rekrutimit dhe detyrat e këtyre formacioneve përgjatë të ashtuquajturit «Sektori i majtë» i «Fontit shqiptar» gjatë viteve 1919-1921.

Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore territori i Shqipërisë politike (shtetit shqiptar) ishte vënë nën «kontrollin e përgjithshëm» të Aleancës së Antantës. Ndërkaq, me vendimin e «Këshillit Ndërkombëtar të Luftës» («Këshillit Suprem të Luftës») të Antantës, Shqipëria politike ishte ndarë në sfera të interesit midis Italisë dhe Mbretërisë Serbe/Serbo-Kroate – Slloven, të cilat shtete me trupat e tyre ushtarake pushtuan Shqipërinë, me përjashtim të disa zonave. Kështu, në mbeshtetje të drejtëpërdrejtë diplomatike e ushtarake të Fuqive të Mëdha, e në veçanti të Francës, në fillim të tetorit 1919, trupat serbe jo vetëm që pushtuan viset shqiptare të aneksuara nga Serbia në vitin 1913, por ata pushtuan dhe zonat lindore e veri – lindore, kufitare të Shqipërisë politike,<sup>1</sup> duke ngritur të ashtuquajturën «Vijë të demarkacionit» apo vija e «Frontit

<sup>1</sup> *Veliki rat Srbije za oslobodjenje Srba, Hrvata i Slovenaca 1914-1918 god.* XXX, Beograd, 1937, f. 36; Bogumil Hrabak, *Reokupacija oblasti srpske i crnogorske države s arbanaske većinom stanovništva u jesen 1918 god. i držanje Arbanasa prema uspostavljennoj vlasti*, «Gjurmime albanologjike», Nr.1, Prishtinë, 1969, f. 260; Vuk Vinaver, *Italjanska akcija protiv Jugoslavije na albanskoj-jugosloveskoj granici 1918-1920*, «Istorijski zapisi», Br. 3. Titograd, 1966 f. 486; Paskal Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë, f. 45-48.

shqiptar», që shtrihej nga Zhleba në veri e deri në Strugë në jug. Vija e «Frontit shqiptar» që ndarë në dy sektore: «Sektori i djathtë» i Prizrenit dhe «Sektori i majtë» i Dibrës. «Sektori i majtë» i Dibrës i «Frontit shqiptar» shtrihej nga lumi Bushterica (Lumë) në veri e deri në Strugë në jug, dhe trupat serbo-jugosllave të përqëndruara përgjatë këtij sektori kishin për detyrë të «mbrojnë» Peshkopinë, Dibrën dhe Strugën.<sup>2</sup> Përkatësisht, «Sektori i majtë» i Dibrës i «Frontit shqiptar» ishte organizuar, në radhë të parë, për të realizuar dy «detyra speciale»: **a.** Okupimin e Pogradecit, **b.** Aksionin lidhur me «Çështjen shqiptare».<sup>3</sup>

**1.** Me qëllim «të qëndresës më të fuqishme kundër aksioneve të italianëve dhe për t'i tubuar e për t'i përvetësuar njerëzit e Esat Pashës kundër shqiptarëve proitalianë», ministri jugosllav i Luftës me urdhëresën Pov. F. Dj. O. Br. 20266 (nuk ka datë) të vitit 1919 themeloi «KËSHILLIN SHQIPTAR» («ALBANSKI ODBOR»), me seli në qytetin e Dibrës.<sup>4</sup> Përpara «Këshillit shqiptar» në Dibër, që nga themelimi i tij, autoritetet jugosllave shtruan shumë detyra. Një nga detyra ishte «Organizimi i shqiptarëve» në «formacionet ushtarake» të armatosura mercenare: batalione, çeta etj., apo të njohura si «batalionet kufitare shqiptare».<sup>5</sup> Ato formacione ndryshe njiheshin dhe cilësoheshin edhe si «ushtria e Esat Pashës», ngase organizoheshin nën fëmën e tij.<sup>6</sup> Formacionet formalisht i organizonte «Këshilli shqiptar» esatis, gjithësesi nën instruksionet dhe patronazhin serbomadh.<sup>7</sup> Gjithashtu edhe «kryetar i Komisionit rekrutues të esatistëve » ishte kryetari i «Këshillit shqiptar» në Dibër, Ymer Efendiu.<sup>8</sup> Ndërkaq, në kuandër të çdo

<sup>2</sup> Desanka Todorović, *Jugoslavija i Balkanske države 1918-1923*, Beograd, 1979, f. 49.

<sup>3</sup> Arhiv na Makedonija (më tej : AM), Skopje, Fond Treta Arm. Obl., Mikrofilm (më tej: M) 343, Pov.Dj. Br. 1152,23o4. 1920, Bitolj; Po aty, Pov. Dj. Br. 2071,17.05. 1920, Skopje.

<sup>4</sup> Më gjerësisht për këtë shih: Halim Purellku, *Këshilli shqiptar esadist në Dibër (1981-1920)*, «Gjurmime albanologjike», Seria e shkencave historike, 26-1996, Prishtinë, 1997; AM, Skopje, Fond Treta Arm. Obl., M. 344, *Memorandum, O razvoju i sadasnjem stanju Albanskog pitanja*.

<sup>5</sup> Arhiv na Institutot za nacionalna Istorija (më tej : AINI) , Skopje, Fond Treta Arm.Obl., K. XXXV/5, Red. Br. 4769, Inv. Br. 3379, 19.07.1920, Skopje.

<sup>6</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/3, Red. Br. 371, Inv.br. nema, *Letër e Cena beut*, 12.12.1919, Dibër.

<sup>7</sup> AM., Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, Pov. Dj. Br. 15.17.o1.1920, Skopje.

<sup>8</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 341, Br. Dps. 69, 8.11.1919, Debar; Po aty, Pov. Dj.Br. 4916, 8.09.1919, Skopje.

formacioni ushtarak «esatist ishin të instaluar oficerë jugosllavë «për lidhje».<sup>9</sup>

Përderisa fillimisht pushteti jugosllav nuk ishte në gjendje me asgjë që ta ndihmojë «Këshillin shqiptar» në Dibër, në aktivitetin dhe veprimtarinë e vet «Këshilli» nuk arriti ndonjë sukses të shënuar, për arsye se nuk dispononte mjete të nevojshme dhe shërbehej vetëm me premtime të kota, e premtimeve pak kush ua vente veshin. Por, kur autoritetet jugosllave filluan t'i ndajnë armë dhe ushqim, atëherë fillon me të madhe të rritet autoriteti i Këshillit, gjë që edhe procesi i organizimit të shqiptarëve në formacionet e armatosura mercenare u përjashpejtua dhe dukshëm përparonte.<sup>10</sup>

Kështu, deri në gusht të vitit 1920, nga pesë batalione, që vepronin përgjatë gjithë Frontit Shqiptar, vetëm përgjatë Sektorit të majtë të Dibrës ishin organizuar dhe vepronin dy batalione nën komandën e majorëve: e Halit Lleshit dhe Tafë Kaziut, si dhe dy çeta nën komandën e kapterëve të klasit të dytë: Xhemail Mehmetit dhe Dine Hoxhës. Por, më 1 gusht 1920 pushoi të funksionojë çeta e Dine Hoxhës, i cili kaloi në anën e kryengritjes shqiptare (gusht-shtator 1920). Ndërkaq, më 25 gusht 1920 pushoi së vepruari dhe çeta e Xhemail Mehmetit, sepse autoritetet jugosllave nën akuzën «për plaçkitje dhe krime të tjera» e burgosën Xhemailin së bashku me një numër të anëtarëve të çetës së tij.<sup>11</sup>

Numri i përgjithshëm i personave të regjistruar në këto formacione-efektivi në njerëz oscilonte nga situata e përgjithshme në «Frontin shqiptar», por dhe nga niveli i seriozitetit të qasjes dhe të kalkulimeve të diplomacive ndërkombëtare në Paris, ndaj Çështjes shqiptare. Kështu, p.sh. deri më 30 mars të vitit 1919 në rrethin e Peshkopisë u regjistruan 3000 xhandarë-mercenar dhe regjistrimi vazhdonte.<sup>12</sup> Në qershor të vitit 1919 në Dibër të Vogël (Poshtme) nga ushri jugosllave kishte të armatosur rreth 2000 shqiptar mercenarë.<sup>13</sup> Kurse, në nëntor të vitit 1919 në Lumë ishin gjithsej rreth 1000 shqiptar

<sup>9</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. M. 342, Pov. Dj. Br. 299, 3.02.1920, Skopje.

<sup>10</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm, Obl., M. 341, Pov. O. Br. 536, 14.05.1919, Debar; Po aty, Pov. Dj. Br. 2355, 22.05.1919, Skopje.

<sup>11</sup> AM, Skopje, F. Treta. Obl., M. 343, Pov. Dj. Br. 8236, 5.12.1920, Bitolj.

<sup>12</sup> AM., Skopje, F. Treta Arm, Obl., M. 341, Br. Telegr. 142, 30.03.1919, iz Debra; Po aty, Pov. Dj. Br. 1441, 1.04.1919, Skopje.

<sup>13</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Br. 5135, 3.07.1919, Beograd; AINI, Skopje, K. XXXV/1, Red.br. 159, Inv. Br. 4116, 5.07.1919, Beograd.

të organizuar.<sup>14</sup> Ndërkaq, në korrik të vitit 1920 në «Sektorin e majtë» të Dibrës ishin gjithsej 1549 shqiptarë të organizuar, ushtar e oficerë: Batalioni i Halit Lleshit kishte gjithsej 691 ushtarë dhe 68-70 oficerë e nënoficerë dhe dy noter. Batalioni i Tafë Kaziut kishte gjithsej 527 ushtarë dhe 108-112 oficerë e nënoficerë dhe katër noterë. Çeta e Xhemail Mehmetit kishte 71 ushtarë dhe 16 oficerë e nënoficerë. Çeta e Dine Hoxhës kishte 47 ushtarë dhe 15 oficerë e nënoficerë. Pra, këto formacione ishin të organizuara mbi parime të strukturës ushtarake dhe, në kuadër të tyre, ishin të angazhuar oficerë të lartë dhe të ulët, duke filluar që nga majori e deri te dhjetari (kapllari).<sup>15</sup>

Kur jemi të shqiptarët e organizuar është me interes të theksojmë edhe se, në dhjetor 1919 Shqir Dema, prijës nga Homeshi, i cili deri atëherë ishte në shërbim të Italisë, siç thonë burimet jugosllave, në dhjetor të vitit 1919 erdhi në Dibër dhe në bisedimet me vicekonsullin-delgatin Nikolla Jovanoviqin shfaqti gatishmërinë e tij, që ai së bashku me njerëzit e vet, rreth 60 veta, sërish të vehet në shërbim të Serbisë-Jugosllavisë dhe t'i ndihmojë qëllimit jugosllav. Për këtë, Shaqir Dema kërkonte nga autoritetet jugosllave t'i jepen atij 300 napoleona për shpenzime, si dhe Halit Lleshi me njerëzit e tij të largohet nga Bulqiza.<sup>16</sup> Lidhur me këtë, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë e njofton komandantin e zonës së divizionit të Vardarit se «Meqë interesat tona kërkojnë që të mbahen lidhje sa më të mira me shqiptarët rreth Peshkopisë dhe Dibrës» lejoj që të miratohet oferta e Shaqir Demës dhe ai të pranohet në shërbim të Jugosllavisë. Të Formohet një çete nga njerëzit e Shaqirit dhe për subvencionimin e saj të kërkohet kredi, sugjeronte komandanti.<sup>17</sup> Mirëpo, meqë formimin e çetës së Shaqir Demës e kundërshtonte rreptë «ëshillin shqiptar»esatist në Dibër dhe Halit Lleshi, ky i fundit edhe refuzoi që të largohet-zhvendoset me forcat e veta nga Bulqiza, komandanti i zonës së divizionit të Manastirit e urdhëroi komandantin e garnizonit të Dibrës që «derisa situata politike nuk kthjellohet, të zvarritet pranimi i njerëzve të Shaqir Demës në

<sup>14</sup>MHD, Peshkopi, ASHSH, Dosja 1, fletorja 1, f. 108,- dod. 798.878, 21.11.1919, Prizren.

<sup>15</sup>AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 344, Br. Dp. .703, 18.07.1920, iz Debra; Po atje, M. 343, Pregled-Jaçina, brojnog stanja ljudstva po – inovima..., 10.11.1920, Debar.

<sup>16</sup>AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj. Br. 654, 26.01.1920, Skopje.

<sup>17</sup>AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj. Br. 414, 29.01.1920, Skopje.

shërbim të Jugosllavisë».<sup>18</sup> Ndërkaq, sa i përket kushtit tjetër, që autoritetet jugosllave t'i japin Shaqir Demës 300 napoleona, më në fund Shaqiri u pajtua edhe me 5000 franga që ia dha vicekonsulli Jovanoviq, në bazë të rekomandimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme. Që tashti Shaqir Dema do të punojë me Jovanoviqin në çështjet politike.<sup>19</sup> Prandaj, për efektuimin e veprimtarisë së tij prej mercenari në krahinën e Dibrës e më gjerë, Shaqir Dema me ftesë të Ministrisë së Punëve të Jashtme, më 12 shkurt 1920 u nis nga Dibra për në Beograd, për të marrë atje instruksione dhe detyra konkrete.<sup>20</sup>

Deri në tetor 1920 nuk ekzistonte asnjëfarë marrëveshjeje me shkrim midis esatistëve dhe autoriteteve jugosllave lidhur me pagesën dhe kryerjen e shërbimit, por ekzistonin vetëm marrëveshje gojore të lidhura qysh gjatë kohës, kur Nikolla Jovanoviq ishte kamandat i Sektorit të majtë. Mirëpo, në tetor 1920 u lidhë dhe u nënshkrua Marrëveshja e koncipuar në të ashtuquajturën Rregullore midis palës jugosllave dhe asaj esatiste, në këtë marrëveshje palën jugosllave e përfaqësonte komandanti i regjimentit XII të këmbësores, kolonel Mihajllo Vasiqi. Kjo marrëveshje-rregullore u lidh me urdhër të komandantit të Trupave të Anadrinit, gjeneralit Smilaniq. Në negociatat për krijimin e këtij kompromisi nga pala jugosllave ishin të pranishëm komandantët e regjimenteve: 21, Mih. Kovaçeviq; 28, Mil. Vllajiq; 18, Drag. Papoviq; 12. Mihajllo Vasiq, pastaj dhe sekretari (delegati) i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Nikolla Jovanoviqi, kurse nga pala esatiste merre pjesë ministri i Qeverisë shqiptare të Esat Pashës, Faik be Kodra dhe komandantët e batalioneve mercenare Halit Lleshi dhe Tafë Kaziu. Mirëpo, në fund, marrëveshja-rregullorja u nënshkrua vetëm nga pala shqiptare – esatiste, ajo nuk u nënshkrua nga asnjë pjesëmarrës i palës jugosllave, siç thuhet, që marrëveshja të mbesë rezervat-fshehtësi. Sepse pala jugosllave ishte e kujdesshme që të mos u japë argumente konkrete shteteve kundërshtarë të jashme për akuza e denoncime ndaj saj. Në atë Rregullore thuhet se: «Shqiptarët janë organizuar nga ana e Esat Pashës me qëllim të jetësimin të programit të tij. Detyra e tyre është politike dhe ushtarake». Në vazhdim të saj përcaktohen konkretisht detyrat, obligimet, sjellja, format e përgjegjesisë, klerarkia e administratës, mënyra dhe forma e armatimit dhe mënyra e pagesës

<sup>18</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M.342, Pov. Dj. Br. 866, 2.02.1920, Skopje; P8 aty, Pov. Dj. Br.654, 26.01.1920, Skopje.

<sup>19</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm, Obl., M.342, Pov. Dj. Br. 866, 2.02.1920, Skopje.

<sup>20</sup> AM, Skopje, F.Treta Arm. Obl., M. 342,Pov.Dj.Br. 505, 12.02.1920, Skopje.

(subvencionimit) të të rekrutuarëve në formacionet mercenare etj. Lidhur me këtë të fundit, thuhet se: Komandantët e batalioneve udhëheqin administratën dhe bëjnë pagesën. Janë të detyruar që njerëzëve të vet pagesën t'ua bëjnë në praninë e delegatit (jugosllav) dhe të anëtarëve të Këshillit (esatist), kur do të tubohen personat e regjistruar për kontroll.<sup>21</sup>

Kështu, tashti, në tetor 1920, mbi bazën e kësaj rregulloreje u bë organizimi i ri i shqiptarëve të organizuar – mercenarë përgjatë *Sektorit të majtë* në dy batalione, sërish njëri nën komandën e Halit Lleshit dhe tjetri nën komandën e Tafë Kaziut. Organizimi i tyre u bë nën drejtimin e komandantit të regjimntit të 12 të këmbësorisë dhe të Sektorit të majtë të Dibrës, Mihajlo Vasiq.<sup>22</sup> Pas riorganizimit, në tetor 1920, që të dy këto batalione, së bashku kishin gjithsej 1200 ushtarë e oficerë, përpjesëtimisht nga 600, përkatësisht nga 98 oficerë për secilin nga ata.<sup>23</sup>

2. Vetvetiu shtrohet pyetja: se në çfarë rrethanash dhe me çfarë motivesh ky numër kaq i madh i shqiptarëve të trevave të lartpërmendurra, në mënyrë të verbër u vunë në shërbim të Esat Pashës dhe me të në shërbim të politikës antishqiptare të Mbretërisë SKS. Kjo çështje është komplekse, ndaj dhe kërkon një qasje multidimensionale: si nga dimensionimi i etnopsikologjisë, rrethanave sociale, nivelit arsimor e kulturor të shqiptarëve etj. Në radhë të parë, filozofia politike serbe ndaj shqiptarëve mbështetet në një konstatim të ngritur në normë: «se elementi shqiptar është më i disponuar ndaj atij i cili jep më shumë, gjë që kjo plotësisht përputhet me karakterin e tyre të egër». Apo «se shqiptarët u nënshtrohen vetëm frigës dhe parave». Pra, si duket, në radhë të parë, nga këto konstatime e vlerësime udhëhiqeshin autoritetet serbo-jugosllave dhe në rekrutimin e konfidentëve shqiptarë, që mjeisht kjo fushatë ishte mjaft e sukseshme për politikën serbe.<sup>24</sup> Gjithsesi për rekrutimin e njerëzve të thjeshtë, me përjashtim të të ashtuquajturve pari dhe përgjithësisht shtresës së pasur, në «batalionet shqiptare» dhe në Shërbimin sekret serbo-jugosllav rol vendimtar luanin dhe kushtet tejet të rënda materiale e sociale në të cilat ata jetonin. Në radhë të parë shqiptarët e organizuar ishin kryesisht nga viset pasive të varfëra, ku popullsia e atjeshm nga të lashtat (korrurat) e veta mund të siguronte

<sup>21</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M.343, *Pravilnik*, Prilog Dj.Br. 128, Pov. Dj.Br. 1405, 25.10.1920; Po aty, Pov. Dj. Br. 8236, 5.12.1920, Bitolj.

<sup>22</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm, Obl., M.343, Pov. Dj. Br. 8236, 5.12.1920, Bitolj.

<sup>23</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, *Pregled, Mesecnog sledovanja za isplatu organizovanih arnauta Ljevog odseka Alb. Fronta*, 15.10.1920, Debar.

<sup>24</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov.Dj. Br. 2850, 15.02.1919, Bitolj.

ushqim më së shumti vetëm për tre muaj. Ashtu që popullata e atyre trevave jetonte në gjendje të varfërisë apo dhe urie.<sup>25</sup> Pra, në mungesë të ndonjë burimi tjetër material për jetesë shqiptarët e organizuar në ato formacione, me paratë që i merrenin në formë të rrogës dhe të racionit ditor, blenin veshmbathj dhe mbajnë familje.<sup>26</sup> Një arsye tjetër për rekrutimin e shqiptarëve ishte se në këtë mënyrë rinia shqiptare i shmangej rekrutimit në formacionet e rregullta ushtarake serbo-jugosllave. Porse, nuk ishte e thënë që të gjithë shqiptarët e organizuar të ishin nga krahinat e Dibrës, por kishte edhe nga viset tjera përreth.<sup>27</sup> Mbi të gjitha, një arsye tjetër ishte dhuna nën forma të ndyshme, që ushtronin autoritetet jugosllav për t'i detyruar sa më shumë shqiptarë të regjistroheshin në formacionet mercenare, batalionet shqiptare. Kështu, p.sh. pushteti jugosllav i detyronte me dhunë shqiptarët nën sundimin e vet që të ndikojnë edhe tek farefisi i tyre përtej vijës kufitare nën sundimin italian, që dhe nga radhët e tyre të regjistroheshin xhandarë në shërbim të Jugosllavisë. Kjo metodë jepte dhe rezultate, sepse për t'i shpëtuar të afërmit e tyre nga represioni i pushtetit serbo-jugosllav, banorët nën sundimin italian shpesh detyroheshin t'i nënshtroheshin propozimit.<sup>28</sup>

Kundër zgjerimit të lëvizjes esatiste në krahinat e Dibrës, Lumës e më gjerë, që në fillim ngrihet zërin e protestës dhe kundërshtimit Komiteti «*Mbrojtja Kombëtare e Kosovës*», por dhe personalitete shqiptare të kohës, të cilët i kishin shumë të qarta pasojat. Në një Qarkore të 2.10.1918, KMKK konstatonte se veprimi i esatistëve në Lumë dhe në Dibër mund të paraqesë rrezikun më të madh. Prandaj, i drejtohet popullatës me thirrjen: «Vllazën! veproni rreptësisht për me i dftue botës ku e ka vendin tradhtia ndër krahina fisnike të kombit shqiptar».<sup>29</sup> Sepse, siç thuhet në një thirrje tjetër të KMKK, në dhjetor 1919, «me armët e Serbisë që keni gjesh, jeni tue prue vdekjen fesë suej, atdheut tuej e kombit tuej». KMKK që atëherë e kishte të qartë dhe e parashihte se në ç'mënyrë do të përfudojnë edhe kolaboracionistët shqiptarë, ashtu siç kanë përfunduar ato gjithherë gjatë historisë, prandaj edhe një herë i rikujtonte ato se: «Serbia mbasi të rregullojë ushtrinë e saj, e mbasi të

<sup>25</sup> AM, Skopje, F. Treta, Arm. Obl., M. 342, Pov. Br. 299, 3.02.1920, Skopje.

<sup>26</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj.Br. 8483, 5.12.1919, Bitolj.

<sup>27</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj.Br. 6321, 12.12.1919, Skopje.

<sup>28</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar (1918-1920)*, I, Tiranë, 1975, dok. nr. 308 f. 473.

<sup>29</sup> MHD, Peshkopi, ASHSH, Dosja nr. 47, Fondi 846, dok. 708.996, 2.10.1918, Shkodër.

marri fuqi, ka me ju ra në qafë dhe ka me ju shtyp kokën nën çizmen e saj»,<sup>30</sup> siç ngjau në të vërtetë. Gjithashtu edhe Fuad beu, përfaqësues i Komitetit Shqiptar të Stambollit, më 11 shtator të vitit 1919, nga Parisi, tërhoqte vërejtjen se «kjo punë e tyre (esatistëve) nuk shkon në favor të atdheut, por në dëm të tij».<sup>31</sup> Mirëpo, veshi i esatistëve dhe konfidentëve të tjerë bëhej i shudhër ndaj zërave të arsyes, sepse ao gjithherë mbi të gjitha, pra dhe mbi Atdheun, venin interesat e tyre egoiste materiale e politike, prandaj dhe deri në fund ato mbetën robër të këtyre interesave, me të, dhe të politikës aneksioniste dhe hegjemoniste jugosllave.

**3.** «Këshilli shqiptar» esatist në Dibër furnizohej me të mira në natyrë nga organet e autorizuara ushtarake jugosllave. Ndërkaq, finacimin e tij me të holla, në emër të Esat Pashës, e bënte vetë Ministria jugosllave e Punëve të Jashtme, fillimisht nëpërmjet konsullit jugosllav në Selanik, Gavrilloviq, dhe pastaj nëpërmjet vicekonsullit-delegatit (organit) të kësaj Ministrie në Dibër, Nikolla Jovanoviqit. Prandaj, «Këshilli shqiptar» në Dibër vepronte edhe nën mbikëqyrjen e vicekonsullit-delegatit Jovanoviq, përkatësisht të Ministrisë së PJ. E gjithë kjo bëhej me dijen dhe lejen e kryeministrit të Mbretërisë SKS.<sup>32</sup>

Pra, «Këshilli shqiptar» esatist në Dibër subvencionohej me të holla nga Ministria jugosllave e Punëve të Jashtme, kurse batalionet e shqiptarëve të organizuar subvencionoheshin nga Ministria e Luftës, për këtë në kuadër të këtyre dy ministrave ishin formuar fonde të veçanta. Për shembull, me propozimin e ministrit të Luftës, gjeneralit Haxhiq, Ministria jugosllave e PJ nëpërmjet vicekonsullit Jovanoviq i dërgoi, në tetor të vitit 1919, «Këshillit shqiptar» në Dibër 20.000 franga në ar. Këto të holla deri në destinimin e fundit – Këshillit, u përcollën nëpërmjet sekretarit të Esat Pashës, Faik bej Kodrës. Ndërkaq, kjo shumë të hollash u nda nga fondi special konspirativ jugosllav, i ashtuquajtur: Fondi i Esat Pashës, i cili ishte krejt i veçantë nga kreditë për subvencionimin e batalioneve shqiptare të organizuara. Kjo shumë në emër të Esat Pashës, u dha në llogari të të ardhurave-rrogës për

<sup>30</sup> MHD, ASHSH, Dosja 1, Fletorja 1, f. 97-100, dok. 708, 10.12.1919.

<sup>31</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M.341, Pov. Br. 1463, 15.09.1919, Debar.

<sup>32</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj. Br. 15, 17.01.1920, Skoplje; AINI, Skoplje, K.XXXV/3, Red. br. 332, Inv. Br. 5769, 6618, Pov. Dj.Br. 5769, 13.11.1919, Skoplje; Po aty, K. XXXV/3, Red. Br. 384, Inv. Br. 6618, Br. Dp. .1555, 26.12.1919, Bitolj-Skoplje, Pov. Dj. Br. 869, Po aty, K. XXXV/3, Red. Br. 332, Inv. Br. 5769, 6618, Pov. Dj. Br.5769, 13. 11. 1919, Skoplje; Po aty, K. XXXV/3 Red. Br. 332, Inv. Br. 5769, 6618, Pov. Dj Br. 6618, 29.12. 1919, Skoplje.

«*Këshillin shqiptar*». Nga kjo shumë, 300 napoleona «*Këshilli shqiptar*» ua dërgoi krerëve esatistë në Krujë,<sup>33</sup> kurse, nga shuma tjetër e mbetur u paguante rrogë edhe krerëve esatistë në Dibër.<sup>34</sup>

Formacioneve të lartëpërmendura ushtarake apo shqiptarëve të organizuar, por dhe grupeve të tjera mercenare, u shpërndahej edhe armatim e municion nga ana e komandave ushtarake jugosllave. P.sh. Komanda e qarkut të regjimentit të Dibrës, me urdhër të komandantit të Sektorit të majtë të Dibrës, në nëntor të vitit 1919 shqiptarëve të organizuar dhe «*Këshillit shqiptar*» në Dibër u kishte dhënë armë e municion.<sup>35</sup> Deri më 22 nëntor 1919 komandanti i Garnizonit të Dibrës u kishte shpërndarë shqiptarëve të organizuar gjithsej: 1221 pushkë të llojeve të ndryshme, 320.660 copë municion dhe 75 bomba ofanzive e defanzive.<sup>36</sup>

Pos që u shpërndahehin armë dhe municion shqiptarëve të organizuar në formacionet ushtarake, atyre u premtoj nga ana e autoriteteve ushtarake jugosllave dhe subvencionim në të holla, përkatësisht të holla në formë të rrogës. Mirëpo, fillimisht për më shumë muaj rrogat dhe racioni ditor në të holla për ushqim shqiptarëve të organizuar vetëm se iu premtuhej dhe nuk iu paguhej.<sup>37</sup> Kjo shkakoi dhe revoltë ndër të ashtuquajturat batalionet shqiptare apo ushtria e Esat Pashës.<sup>38</sup> Meqë tashti premtimeve të kota të autoriteteve jugosllave jo vetëm që shqiptarët e organizuar filluan të mos ua vënë veshin, por dhe ishin kontraproduktive për objektivin e politikës serbo-jugosllave në shqiptarët. Prandaj edhe ministri i Punëve të Jashtme të Mbretërisë SKS i drejtohet me një akt ministrit të Luftës, gjeneralit Haxhiq, se ka informata që pos propagandës italiane, një nga arsytet për mossuksesin e pacifikimit të shqiptarëve qendron se pushteti ushtarak dhe ai civil nuk respektojnë Besën e dhënë, vetëm se japin premtime të cilat nuk janë në gjendje t'i përmbushin. Një praktikë e tillë është në dëm të interesave shtetërore, konkludonte ministri. Lidhur me këtë reagoi ministri Haxhiq, i cili më 8 qershor 1919 kërkonte nga komandanti i krahinës së Armatës së Tretë,

<sup>33</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K.XXXV/2, Red. Br. 237, Inv. Br. Nema, *Letër e Ymer Efendiut*, «*Drejtoritë kryesorë për Shqipëri*», 7.08.1919, si dhe letra tjetër që ia dërgoi Husein Efendiut, 8.10.1919.

<sup>34</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 341, Pov. O. Br. 1547, 5.10.1919, Debar.

<sup>35</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 431, K. P. Pov. Br. 1572, 16.11.1919, Debar.

<sup>36</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 341, K. Pov. Br. 215, 22.11.1919, Debar.

<sup>37</sup> AM., Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj. Br. 299, 3.02.1920, Skoplje.

<sup>38</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 341, *Sifra iz Beograda*, 19.08.1919.

që ai të marrë masa më të rrepta ndaj personave ushtarake të cilët jepnin premtime të porealizueshme. Ministri urdhëronte që të jepen vetëm premtime reale, që do të mund të përmbusheshin dhe me të cilat do të fitohej besim ndër shqiptarët. Sipas kësaj urdhërese, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë ndërmoi edhe hapa konkrete.<sup>39</sup> Mirëpo, edhe më tej shqiptarëve të organizuar nuk u jepeshin rrogat nga ana e organeve përkatëse serbo-jugosllave. Ata (mercenarët) ishin në gjendje të rëndë social, kështu konstatonte edhe Cena beu (Kryeziu) në një letër që ia dërgoi gjeneral Vasiqit, më 12.12.1919, ku veç tjerash, ai thoshte se gjatë qëndrimit të tij në Dibër, në takimin që pati me «*Këshillin shqiptar*» dhe me Halit Lleshin, ata i thanë se janë në pozitë shumë të vështirë për shkak se njerzëve të tyre nuk u paguhen rrogat. Pa ua paguar rrogat dhe racionet për ushqim në të holla, ata njerëz nuk mund të bëjnë asgjë, sugjeronte Cena beu.<sup>40</sup> Përpara kësaj gjendjeje në terren, qeveia serbo-kroato-slllovene, përkatësisht Komiteti i ministrave që nga fundi i vitit 1919 filloi të ndajë kreditë për subvencionimin e batalioneve shqiptare. Kreditë i ndaheshin ministrisë së Luftës, e cila kishte formuar fond të veçantë për këtë qëllim, kurse qendër e distribuimit të të hollave të këtij fondi ishte Komanda e krahinës së Armatës së Tretë në Shkup, gjegjësisht kjo Komandë qeveriste me këtë fond.

Kështu, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë në raportin që ia dërgonte ministrit të Punëve të Jashtme të Mbretërisë SKS, më 13.11.1919, thotë se deri më tashi kësaj Komande i është dhënë kredi për subvencionimin e batalioneve shqiptare në një shumë të përgjithshme prej 512.513 dinarësh nga kjo shumë Këshilli i Esatit në Dibër nuk do të marrë asnjë dinarë, ngase ai subvencionohej nga fondi tjetër i veçantë, nga fondi i Esat Pashës.<sup>41</sup> Kurse në raportin tjetër të 3 janarit të vitit 1920, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë e njoftonte, nëpërmjet ministrit të Luftës; ministrin e Punëve të Jashtme të kësaj Komande, se i janë miratuar kreditë për subvencionimin e batalioneve shqiptare dhe se ka marrë masa që atyre batalioneve t'u paguhen të gjitha të hollat e pa paguara deri atëherë, por, se në të ardhmen pagesa do të bëhet në

<sup>39</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 341, Br. Telegr. 3778, 8.06.1919, iz Beograda, Pov. Dj. Br.27161; Po aty, Pov. Dj. Br. 2603, 8.06.1919, Skoplje.

<sup>40</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm Obl., K. XXXV/3, Red. Br. 371, Inv. Br. Nema, *Letër e Cena beut*, 12.12.1919, Dibër.

<sup>41</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/3, Red. Br. 332, Inv. Br. 5769, 6618, Pov. Dj.Br. 5769, 13.11.1919, Skoplje.

rregull.<sup>42</sup> Përkundër gjithë kësaj, deri në dhjetor të vitit 1919 shqiptarët e oraganizuar në terren kishin pranuar vetëm dy rroga dhe një këst në të holla për racion ditor për ushqim. Racioni ditor paguhej nga 1 dinar në ditë dhe pagesa bëhej për periudhën vetëm nga 1 shtatori 1919, sepse aq të holla ishin lëshuar për këtë destinim nga ana e organeve përkatëse jugosllave.<sup>43</sup>

Duket se kishte edhe keqpërdorime të këtyre të hollave (mjeteve). Kështu, në nëntor 1919 më shumë ushtarë të batalionit të Halit Lleshit iu ankuan togerit Boshko Rashiq, i cili ishte në shërbim pranë këtij batalioni, se Haliti nuk u ka paguar asnjëfarë rroge, prandaj ata i kërkonin aij që t'u paguhen të gjitha rrogat e pa paguara.<sup>44</sup> Po ashtu, deri në dhjetor të vitit 1919 as njerëzve të Xhemail Mehmetit (Efendiut) nuk u kishin dhënë të holla as në formë të rrogës, e as për ushqim – racion ditor. Për këtë, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë kërkonte shpjegim nga komandanti i zonës së divizionit të Manastirit.<sup>45</sup>

Për vitin 1920 autoritetet jugosllave synonin që sa i përket subvencionimit të rregullt të shqiptarëve të organizuar ato të jenë më të përpikta. Kështu, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë më 9 janar 1920 e njoftonte ministrin e Luftës: «Për të paguar shqiptarët për qëllimet tona për vitin 1920 është e nevojshme një shumë prej 3 milion e 64 mijë e 400 dinarë».<sup>46</sup> Edhe pse buxheti i shtetit për vitin 1919-1920 ende nuk ishte miratuar, Komiteti i ministrave të Mbretërisë SKS në mbledhjen e vet më 28 janar 1920 miratoi kredinë e kërkuar për subvencionimin e shqiptarëve të organizuar për muajt janar dhe shkurt të këtij viti, me një shumë të përgjithshme prej 540.650 dinarësh. Ndaj dhe Ministria e Financave në njoftimin për këtë vendim, i sugjeronte Ministrisë së Luftës dhe marinës se menjëherë mund të fillojë distribuimi i këtyre mjeteve. Përderisa i miratohet buxheti kjo shumë e të hollave do të hyjë në «llogari të pagesave të përkohshme nga kreditë e paparashikar në buxhetin për vitin 1919-1920, ashtu që pastaj në mënyrë plotësuese kjo

<sup>42</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 344, Pov. Dj. Br. 43, 3.01.1920, Skoplje; Po ky dokument dhe në: AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/4, Red. Br. 399, Inv. Br. 43.

<sup>43</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/3, Red. Br..., Inv. Br. 6618, Br. Dp.1555, 26.12.1919, Debar.

<sup>44</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj. Br. 8483, 5.12.1919, Bitolj.

<sup>45</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 342, Pov. Dj. Br. 6321, 12.12.1919, Skoplje; AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/1, Red. Br. 384, Inv. Br. 6618, Pov. Dj. Br. 6618, 30.12.1919, Skoplje.

<sup>46</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. Pov. Br. 31, 9.01.1920, Skoplje.

kredi do të hyjë në buxhetin për vitin 1919-1920.<sup>47</sup> Edhe për muajt që do të pasojnë në fondin për subvencionimin e shqiptarëve të organizuar do të derdhen shuma të reja të të hollave. Vetëm për subvencionimin e batalioneve shqiptare (dy batalione e dy çeta ) në Sektorin e majtë për muajt janar – maj 1920, në emër të rrogave u dhanë gjithsej 870.800,50 dinarë. Kështu, major Halit Lleshit (komandant batalioni) iu dhanë gjithsej 470.586 dinarë, major Tafë Kaziut (komandant batalioni) 330.271 dinarë, kapter i kl. të dytë Xhemail Mehmedit (komandant çete) 44.263 din; kapter i kl. të dytë Dine Hoxhës komandat çete) 25.680. 50 dinarë.<sup>48</sup>

Ndërkaq, Komanda e zonës së divizionit të Manasirit shprehet se për subvencionimin e shqiptarëve të organizuar për muajin korrik 1920 nevojiten 290.000 dinarë.<sup>49</sup> Mirëpo, në rrethana të reja, që u krijuan pas shpërbërjes së çetave të Xhemail Mehmedit dhe të Dine Hoxhës, sipas parrallogarive të komandantit të zonës së divizionit të Manasirit tashti për subvencionimin e shqiptarëve të organizuar në sektorin e majtë, është i nevojshëm krediti prej 75.000 dinarësh në muaj.<sup>50</sup> Ashtu që edhe Ministria e Luftës për muajin shtator 1920 lejoi kreditë për subvencionimin e shqiptarëve të organizuar, në të dy sektorët (të majtë dhe të djathtë), me një shumë të përgjithshme prej 143.000 dinarësh. Nga kjo shumë 75.000 dinarë iu ndanë shqiptarëve të organizuar në Sektorin e majtë të Dibrës.<sup>51</sup> Organet përkatëse jugosllave tashti llogaritnin që secilit nga dy batalionet e riorganizuar, në tetor 1920, (batalionit të Halit Lleshit dhe atij të Tafë Kaziut) për çdo muaj t'i u jepen në emër të rrogës dhe të hollave për ushqim-ration ditor nga 77.105 dinarë. Mirëpo, niveli i rrogës për çdo kategori të të organizuarëve në ato formacione varionte. Kështu, majori kishte rrogë mujore prej 675 dinarë, kapteri merrte 427 din., togeri merrte 270 din., noteri merrte 125 din., «naredniku» – 100 din., «podnaredniku» – 96 din., «kapllari» – 92 din., dhe ushtari merrte 90 dinarë në muaj. Që të gjithë këta merrnin edhe nga një dinar në ditë për ushqim-ration ditor.<sup>52</sup>

**4.** Këto formacione si ushtarake apo batalionet kufitare shqiptare autoritetet serbo-jugosllave i kishin dislokuar-sistematizuar përgjatë vijës

<sup>47</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, Dj. Br. 10725, 14.02.1920, u Beogradu.

<sup>48</sup> Am, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, Pov. Dj. Br. 8236, 5.12. 1920, Bitolj.

<sup>49</sup> AM, Skopje, F. Trta Arm. Obl., M. 343, Br. Dp. 246, 3.07.1920, iz Bitolja.

<sup>50</sup> AM, Skopje, f. Treta Arm. Obl., M. 343, Br. Dp. .1807, 14.8.1920, Bitolj.

<sup>51</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M.. 343, Pov. Dj.Br. 853, 1.09.1920, u Beogradu.

<sup>52</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, *Pregled, Mesečnog sledovanja za isplatu organizovanih arnauta Levog odsaka Albanskog fronta*, 15.10.1920, Debar.

së Fontit shqiptar, e diku edhe përpara ushtrisë serbo-jugosllave. Prania e këtyre kufitarëve paraqiste njëfarë force dëbuese apo një mur të gjallë midis trupave jugosllave dhe atyre italiane dhe në këtë mënyrë roli i këtyre formacioneve si ushtarake ishte që të pengonin afrimin eventual të trupave italiane kah trupat jugosllave të dislokuara përgjatë vijës së Frontit shqiptar, duke iu dhënë kohë trupave jugosllave të bëjnë organizimin dhe rekognoscimin e nevojshëm. Kësisoj, këto forca mercenare aso kohe përforconin ushtrinë jugosllave si forca shtesë të saj. Për momentin, roli i këtyre forcave mercenare ishte më shumë rëndësi, ngase garnizoni jugosllav në Dibër «ishte shumë i dobët» në efektiva në pushkë, kurse vija kufitare që e siguronte ishte «shumë e madhe». Prandaj, nga shqiptarët e organizuar në fillim kishim dobi të mëdha, vlerësonte komandanti i krahinës së Armatës së tretë në raportin, që ia dërgonte më 2 shkurt 1920 ministrit të Luftës.<sup>53</sup> Ndërkaq, nga ana e tij, ministri jugosllav i Punëve të Brendshme vlerësonte se «për formimin e atyre batalioneve diktonin kushtet politike dhe fillimisht mungesa e trupave tona në kufirin shqiptar».<sup>54</sup>

Krahas detyrave ushtarake, këto formacione ishin ngarkuar nga ana e zyrtarëve serbo-jugosllavë edhe me detyra politike. Pos agjitacionit dhe propagandës që zhvillonin, ata shpesh herë ndërseheshin nga padronët e tyre jugosllavë që, të ndërmarrin edhe aksion diverzante në zonat nën administratën e qeverisë shqiptare me qëllim që ta destabilizojnë atë administratë. Gjithashtu, ata sa herë që e kërkonte nevoja serbo-jugosllave ndërmernin aksione povokuese në «kufij», për tu justifikuar pastaj interevencionet ushtarake serbo – jugosllave ndaj Shqipërisë, gjatë të cilave aksione edhe ata në mënyrë aktive ishin të angazhuar përkrah trupave serbo-jugosllave.

Mirëpo, autoritetet jugosllave nuk kishin gjithëherë vlerësime dhe qëndrime konstante, por as besim ndaj rolit dhe veprimit të shqiptarëve të organizuar. P.sh. ministri i ushtrisë kishte informata, kah mezi i vitit 1919, se njerëzit e Esatit punonin për Shqipërinë e Madhe, ndaj dhe komandanti i krahinës së Armatës së Tretë, sipas sygjerimit nga lart, kërkonte nga komandantët e sektorëve të djathtë e të majtë që të përcillet

<sup>53</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. Pov. Dj. Br. 299, 3.02.1920, Skoplje.

<sup>54</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, Pov. Dj. Br. 3379, 19.07.1920, Skoplje; Po ky dokument: AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/5. Red. Br. 497. Inv. Br. 3379.

puna e esatistëve dhe ta informojnë atë për gjithçka.<sup>55</sup> Apo rasti tjetër ishte kur komandanti i krahinës së Armatës së Tretë, më 8 shtator 1919 refuzoi kërkesën e Ymer Efendiut që të udhëtojë për në Selanik, sepse vlerësonte se Ymeri nuk shkon atje, siç thoshte ai, për t'u takuar me Qeverinë shqiptare, e cila nuk ekzistonte, e as për kontrollim mjekësor, por në të vërtetë ai shkonte për t'u takuar me *Këshillin shqiptar* në Selanik, që ishte nën patronazhin grek.<sup>56</sup>

Gjithashtu, shpesh ishte çështje debati midis niveleve të pushteti ushtarak dhe më gjerë se a është e nevojshme të ekzistojnë dhe më tej formacionet e shqiptarëve të organizuar dhe në ç'mënyrë të bëhet shpërbërja eventuale e tyre, gjegjësisht demobilizimi i tyre. Si duket, kjo çështje, sërisht u ngrit nga ana e prefektit të qarkut të Ohrit. Ai në një raport të tij, më 13.11.1919, njoftonte se ushtarët e Esat Pashës dhe eprorët e tyre për çdo ditë ushtronin dhunë mbi popullatën e Dibrës së Poshtme dhe të Gollobordës, si dhe e cenonin renin. Ata, thotë ai, popullatës ia grabitnin kafshët dhe mallin në emër të furnizimit të asaj ushtrie, ata që nuk kishin mall paguanin të holla. Nga një gjendje e këtillë, popullata e atyre viseve detyrohej të largohet nga vatrata e tyre për t'i shpëtuar dhunës. Kështu, kjo çështje do të bëhet çështje e qeverisë serbo-koato-slllovene. Me ndërhyrjen e Ministrit të Punëve të Brendshme të ministri i Luftës dhe Marinës, komandanti i krahinës së Armatës së Tretë më 22 nëntor 1919 kërkonte nga komandanti i zonës së divizionit të Manastirit që ai të raportojë, se a është edhe më tej e nevojshme që ushtria dhe oficerët e Esat Pashës të mbetën si të tillë në rrethet e Peshkopisë dhe të Golobordës, apo të shpërbëhen.<sup>57</sup> Lidhur me këtë, komandanti i garnizonit të Dibrës konstaton se për më shumë arsye, por në radhë të parë, arsyeja kryesore është se ende nuk është definuar kufiri me Shqipërinë, prandaj duhet që edhe më tej të mbesin të organizuara batalionet shqiptare. Për këtë u bind edhe komandanti i krahinës së Armatës së Tretë, në raportin që ia dëgoi ministrit të Luftës, më 3.02.1920, vlerësonte se për arsye të kushteve politike, meqë ende nuk është cakuar kufiri me Shqipërinë dhe se përparësi kanë italianët,

<sup>55</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/2, Red. Br. 158, Inv. Br. 3059, Pov. B...,4.07.1919, Skoplje.

<sup>56</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 341, Br. Dj. 69, 8.09.1919, Debar; Po aty, Pov. Dj. Br. 4926, 8.09.1919, Skoplje.

<sup>57</sup> AINI, Skopje, F. Treta Arm. Obl., K. XXXV/3, Red. Br. 335, Inv. Br. 5998, Pov. F. Dj. Br. 41603, 13.11.1919, Beograd, Po aty, Pov. Dj. Br. 5998, 22.11.1919, Skoplje; AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. 343, Pov. F. Dj. Br. 41603, 13.11.1919, Beograd; Po atje, M. 344, Pov. Br. 5998, 22.11.1919, Skoplje.

shqiptarët e armatosur të organizuar duhet dhe me tej të ekzistojnë.<sup>58</sup> Kjo çështje u mbyll në Konferencën në Shkup, që u mbajt me 25 korrik 1920, në të cilën morën pjesë: ndihmësi i kryeshefit të Shtabit të Armatës së Tretë, kryeshfi i shtabit të divizionit të Manastirit, nënkoloneli M. Vasiq, prefekti i qarkut të Shkupit, Rashkoviqi, delegati-vicekonsulli i Ministrisë së PJ, Nikolla Jovanoviqi, nënprefekti i rrethit të Dibrës, komandanti i Sektorit të majtë të Dibrës. Në këtë konferencë, pas një debati u mor vendimi, thuhet unanim, që për momentin të mos ndërmerret hapi për shpërbërjen e batalioneve shqiptare.<sup>59</sup> Batalionet shqiptare praktikisht vepruan deri në fund të vitit 1921, kur u larguan nga Shqipëria ushtritë serbo-jugosllave.

Halim PURELLKU

## THE ALBANIAN BORDER BATTALIONS IN THE LEFT SECTOR OF DIBRA OF THE ALBANIAN FRONT (1919-1921)

### *Summary*

The organization of the Albanians in mercenary military units, battalions, files, etc, known as the Albanian border battalions, or as the Army of Esat Pasha, started on 1919. Certain «Albanian Council» formally ran these formations, but in fact, Yugoslav authorities set them up. Along the Third Sector, there acted two battalions and two files.

The Yugoslav government itself, through the Ministry of Foreign Affairs and Ministry of War, which had created secret funds for this, did the subsidization of the «Albanian Council» and of these mercenary formations.

These formations served as reserve forces for the Yugoslav Army in the Albanian front. Apart military tasks, these formations were politically tasked as well, first to provoke inter-Albanian conflicts, then to destabilize the administration of the Italian occupation area in Albania, and to provoke conflicting situations along the Albanian front whenever Belgrade needed a pretext for open military interventions in Albania.

<sup>58</sup> AM, Skopje, M. Treta Arm. Obl., M. 344, Pov. Br. 415, 11.12.1919, Debar; Po atje, M.342, Pov. Dj. Br. 299, 3.02.1920, Skoplje.

<sup>59</sup> AM, Skopje, F. Treta Arm. Obl., M. Pov. Br. 335, 6.08.1920, u Debru.

